

# Ditari Natyrës

## Në këtë numër do të gjeni:

- **Njerëzimi dhe bashkëjetesa me Zonat e Mbrojtura.**
- **Harta e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura dhe Ramsar në Shqipëri.**
- **Rrjeti i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri.**

### *Njerëzimi dhe bashkëjetesa me Zonat e Mbrojtura*

Në larminë e perlës së natyrës të vendit, në mënyrë të veçantë në zona të mbrojtura, spikatin ekosistemet tokësore e ujore, dhe në përbërje të tyre, habitatet dhe llojet floristike e faunistike, të cilët shtrihen nga brezi detar-bregdetar deri në atë fushor-kodrinor dhe më në thellësi, në malet e lartë të një rëndësie kombëtare e ndërkombëtare. Ende ka zona natyrore e gjysmë-natyrore, ku shkalla e ndërhyrjeve njerëzore mungon ose pothuajse është pak e ndjeshme. Këto zona, madje ruajnë vlerat e tyre të vërteta të biodiversitetit, kështu që kërkojnë vëmendje e kujdes të veçantë.

Tradicionalisht mënyra më efektive dhe më gjerësisht e përdorur, për arritjen e ruajtjes së natyrës, është krijimi dhe menaxhimi i rrjetit të zonave të mbrojtura. Zona e mbrojtur luan rol të rëndësishëm në mbështetjen e politikave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për biodiversitetin. Përmbajnë disa nga vlerat më të mëdha të vendit nga pikëpamja ekologjike dhe ekonomike, ku përveçse mbrojtës dhe garantues të larmisë së botës të gjallë, shërbejnë edhe si burim ekzistence, të mirash materiale dhe të ardhurash për komunitetin. Njëherazi dhe si vende për studime e kërkime shkencore, për

konservimin e florës e faunës së egër, sigurimin e shërbimeve të ekosistemit si edukimi, turizmi, rekreacioni, kënaqësisë, estetike dhe mbrojtjen e veçorive historike e kulturore apo dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike.

Zonat e mbrojtura janë një nga trashëgimitë më të mëdha që njerëzimi mund të lërë për brezat e ardhshëm për të garantuar që pasardhësit tanë të kenë akses ndaj burimeve natyrore dhe përfitimeve materiale e jo-materiale që ato sigurojnë. Por, zonat e mbrojtura ekzistojnë në një mjedis që ndryshon me shpejtësi dhe përballen me sfida të shumta.

Një sërë çështjesh janë evidente, që përfaqësojnë si mundësi dhe kërcënime reale për zonat e mbrojtura. Pasqyruar këto me ndotjen e mjedisit, dëmtime të habitateve e llojeve, llojet e huaja, fragmentimi i peizazheve natyrore, prerja e pyjeve, zjarret, gjuetia, kullotja, mbi peshkimi, nga ndryshimet klimatike, rritja e urbanizimit, zëniet dhe ndërtimet pa kriter, turizmi i papërgjegjshëm, zhvillimi i infrastrukturës, ndërtimi i

*Vijon në faqe 2*



Vijon nga faqe 1

HEC-ve, i moleve apo të ashtuquajtura pista në bregdet, guroret, shtimi i nevojës për burime natyrore, etj. dhe kërkesat gjithnjë në rritje për tokën dhe ujërat, nisur nga lakmitë jo miqësore të bizneseve me natyrën dhe biodiversitetin.


Në mjaft raste një partneritet i tillë është tepër i dëmshëm për natyrën dhe biodiversitetin. Shkatërrimi dhe tjetërsimi i tyre ndikon ndjeshëm në zhvillimin e vendit. Shembuj të tillë janë të shumtë. Ndërkohë që fitimet e çastit janë të majme, por nuk do të jenë kurrë fitimprurëse më pas, dhe nuk do të kenë një qasje të denjë për brezat e ardhshëm. Pra, një partneritet i tillë bie ndesh me zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshur të ecurisë social-ekonomike të komunitetit, me përdorimin e burimeve bio - natyrore, duke mos respektuar asnjë nga standardet e menaxhimit të zonës së mbrojtur.

Shumëllojshmëria e peizazhit nuk konsiderohet burim i veçantë për zhvillimin e ekonomisë dhe të turizmit. Të cenohet deri në tjetërsim peizazhi detar e bregdetar, riviera Joniane dhe e Adriatikut apo dhe peizazhi kodrinor, malor dhe rural, nuk është zgjidhje e mençur. Ndaj peizazhit sjelljet njerëzore dhe veçanërisht e biznesit janë të pakuptimta. Duhet të punohet, të ndërjegjësohet dhe të zgjerohet pjesëmarrja e komunitetit vendor në qeverisjen dhe vendimmarrjet për ruajtjen e biodiversitetit dhe të peizazhit, në forcimin e kontrollit dhe përmirësimi i ligjshmërisë. Për më tepër, në shumë zona të mbrojtura mungon mbështetja politike, kanë burime të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore.

Politika mjedisore gjithnjë e më tepër, në bashkëpunim me të gjithë palët e interesuara, duhet të bazohen në parimet e ruajtjes, dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore, në partneritet zhvillimi në mënyrë që të sigurojmë një prosperitet social, promovim dhe përmirësimi të sistemit të menaxhimit të zonës së mbrojtur me një koncept të ri.

**Nihat Dragoti**

Përgjegjës i Sektorit të Zonave të Mbrojtura dhe Parqet Kombëtare  
 MMPAU



Harta e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura dhe Ramsar në Shqipëri.

## Rrjeti i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri

VITI 2013-QERSHOR

Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,800.0
<b>SHUMA I</b>		<b>Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor</b>				<b>2</b>	<b>4,800.0</b>
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96,datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96,datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96,datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96,datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Krujë	Qafë Shtamë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80,datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr. 134,datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402,datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tirane	Tirane	Mali i Dajtit	VKM nr.402,datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Kruje	Mali i Dajtit	VKM nr.402,datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687,datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687,datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687,datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687,datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640,datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640,datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukës	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640,datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korce		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008		33,165.3
		Korce	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	PKD "Karaburun-Sazan"	VKM nr.289, date 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorit	VKM20 nr.432,datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorit	VKM nr. 432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorit	VKM nr. 432, datë 18.07.2013		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorit	VKM nr. 432, datë 18.07.2014		1,278.9
<b>SHUMA II</b>		<b>Park Kombetar</b>				<b>15</b>	<b>210,501.4</b>
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676,datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676,datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676,datë 20.12.2002	750	0.0
<b>SHUMA III</b>		<b>Monument Natyre</b>					<b>3,470.0</b>
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2,datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gëmenj-Shelegur	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr. 684,datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukës		Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011	1	55,550.2
		Diber	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011		20,663.4
		Kukës	Kukës	Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011		34,886.8
47	IV	Diber	Mat	Park Natyror Rajonal "Ulza"	VKQ nr. 16, date 03.04.2013	1	4,206.0
<b>SHUMA IV</b>		<b>Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror</b>				<b>23</b>	<b>127,180.1</b>

Vijon nga faqe 3

48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80,datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680,datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682,datë 02.11.2005	1	23,027.0
52	V	Tiranë,Diber,Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	SHUMA V		Peizazh I Mbrojtur			5	95,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	2,200.0
	SHUMA VI		Zone e Mbrojtur e Burimeve te Menaxhuara			4	18,245.0
	TOTALI i ZM				16.00%	799	460,060.9

	Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.54%	446,799.7
			Sip. Detare, Ha		13,261.2
a	VKM	Vendim Keshilli Ministrave		Karaburun-Sazan	12,428.0
b	VKQ	Vendim Keshilli Qarkut		Butrint	833.2
c	MB	Ministria Bujqesise	Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95% 119,401.5

**LISTA E ZONAVE RAMSAR**

1	RAMSAR	Fier	Lushnje	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413,datë 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
	TOTALI				%/Totali Republikës	2.89%	83,062.0

**Burimi:** MINISTRIA MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
 DREJTORIA E BIODIVERSITETIT  
 SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA DHE PARQET KOMBËTARE  
 Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.  
[www.moe.gov/](http://www.moe.gov/) Zonat e mbrojtura

**NJOFTIME**

- 1- Mediterranean Basin Biodiversity Hotspot. The CEPF Regional Implementation Team announce the next Call for Letters of Inquiry for Small Grants. This call is open to biodiversity conservation Project eligible for Strategic Direction 2 ...*për më tepër...* <http://www.birdlife.org/community/cepf-mediterranean/>
- 2- Mediterranean Basin Biodiversity Hotspot. The CEPF Regional Implementation Team announce the next Call for Letters of Inquiry for Large Grants. This call is open to biodiversity conservation Project eligible for Strategic Direction 2 ...*për më tepër...* <http://www.birdlife.org/community/cepf-mediterranean/>

**Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës**

• **Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.**

**Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.**

**Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!**

• **Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.**

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës  
 Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro